L I G J
Nr.7991, datë 14.9.1995

PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.7846, DATË 21.7.1994 "PËR NDËRTIMIN, ADMINISTRIMIN, MIRËMBAJTJEN DHE SHFRYTËZIMIN E SISTEMEVE TË UJITJES DHE KULLIMIT"

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Neni 9 i ligjit nr.7846, datë 21.7.1994 "Për ndërtimin, administrimin, mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin e sistemeve të ujitjes dhe kullimit" ndryshohet si vijon:

"Drejtoritë e ujërave të rretheve administrojnë sistemet kryesore ujitëse dhe kulluese.

Në këto sisteme kanalet ujitëse e kulluese kryesore dhe të dyta, stacionet e pompimit të ujitjes e të kullimit dhe veprat e artit me strukturat e tjera përkatëse mirëmbahen dhe shfrytëzohen me shpenzimet e drejtorive të ujërave.

Kanalet ujitëse dhe kulluese të brendshme me veprat përkatëse të artit, që ujitin ose kullojnë deri 15 ha tokë bujqësore, mirëmbahen dhe shfrytëzohen me shpenzimet e tyre nga shoqatat e përdorimit të ujit që përfitojnë nga këto sisteme.

Përdoruesit e ujit që marrin ujë nga këto sisteme, paguajnë tarifën e ujitjes (kanal i parë, i dytë, i tretë).

Rehabilitimi i sistemeve të ujitjes të të gjitha niveleve të dëmtuara, deri në daljen e këtij ligji, bëhet me investime shtetërore e private, vendase e të huaja, nëpërmjet njësive të ngarkuara nga dikasteri përkatës.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.1214, datë 25.9.1995 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha